


HURMA ÇALLËKU



Me sytë e diellit kundroj
Poezi

BSH-1
ç 18

HURMA ÇALLËKU

ME SYTË E DIELLIT
KUNDROJ
POEZI



“Marin Barleti” 2010

Hurma Çallëku

ME SYTË E DIELLIT KUNDROJ
POEZI

Redaktor letrar: Arlind Shabani

Ideoi kopertinën dhe Art grafik: Dashamir Vraniçi

© Copyright Hurma Çallëku, 2010

Libri u shtyp në Shtypshkronjën e Shtëpisë Botuese
"Marin Barleti" Tiranë

* * *

Jo pa qëllim në një veprën time, romanin "Kryefjala e fatales" jam shprehur: "Sakatëria nuk është sakatëri, nëse në trup diçka të mungon; sakatëria është sakatëri, në rast se truri ka lëvizur nga vendi i tij"...

Edhe në rastin ekstrem, kur sytë e kanë humbur shikimin e tyre, njeriu i tillë botën e percepton dhe e "kundron" me shqisat e tjera, të cilat forcohen dhe mundohen të lozin rolin e shqisës që ka humbur aftësinë. Një rast i tillë ndodh edhe me autoren e këtij vëllimi modest poetik.

Një libër ky, i cili ka në përmbajtjen e tij një larmishmëri temash, të parë nga një këndvështrim me forcë diellore... Autorja me botën e saj shkrimore tregon figurativisht praninë dhe rolin jetësor, zbulon me domethënie "akte të pazbuluara "të jetës , që mund të mos i kundrojë edhe një njeri i zakonshëm, syshikues, por sytë i ka të mbyllura nga realiteti, pra, i cili, ka pikshikim tërësor me realitetin dhe domethënien e tij. Raste të kësaj natyre, pothuajse identike, që kanë lojtur një rol domethënës në jetë kanë qenë të pranishëm dhe koha vërteton se, të tillët janë prezentë. Rast protagonist ka qenë Nikolla Ostrovski, i cili shkroi një vepër madhore "Si u kalit çeliku"... në kushte të mungesës të pamit.

Termi "I verbër" në raste të këtilla lëkundet. Autorja Hurma Çallëku trajton tema të tilla si ato të sferës psiko - morale, të dashurisë ndaj vendlindjes, të emigrimit "total' dhe të rikthimit, të dualitetit jetë - vdekje dhe të triumfimit të së parës, të teatralitetit real, të përkufizimit njerëzor, të luftës

ndaj trajtesës viktimizuese, të temave madhore të vendit, e sidomos asaj të Kosovës, të lindjes së shkrepimave dashurore, apo duke prekur edhe gjininë e fabulës. Temë e trajtuar me ëmbëlsi ajo e Nënës, e Shqipërisë, por duke mos harruar "protestën" që vlon në shpirt e zemër për ata të kanë humbur të pamit. Me figuracion të thjeshtë, të kuptueshëm, duke mos arritur në figuracion të arrirë, ajo zbraz botën e saj shpirtërore në dhimbjet që ka, duke e bërë këtë dhimbje dhe idetë pronë të lexuesve që këta të pozicionohen dhe të mos lënë në procesë harrese këtë kategori njerëzore, e cila ka dhënë kontribut në jetën shoqërore. Kontakti tashmë i rikrijuar ndryshe me botën të kësaj autore, të impulson të ndërmarrësh "aksionin" e ndihmesës dhe të daljes në pah të këtij libri modest, i cili, me substratin e tij, të pikëtakon dhe të detyron të apelojë për ndihmesë, ku Shoqëria Civile me organizacionet e saj, pa dyshesë duhet të japë kontribut. Libri "Me sytë e Diellit kundroj" është një "metaforë" intriguese dhe domethënëse si dhe një akt në veprim; është një tufë mesazhi për Shoqërinë, individin dhe gjithë organizmat drejtuese e të zgjedhura për të kthyer sytë nga këta njerëz, të cilët e kanë shpirtin të mbushur me shpresë dhe dritë njerëzore.

Qëmtimi i këtij "tufëzimi" ndjenjash nga ana jonë është një shembull dinamik. Nuk ka rëndësi, në këtë kontekst, se a ka arritje letrare të mirëfilltë, por ka rëndësi dalje në pah dhe shpërthim qëndrimi i njerëzve që, ndoshta, e ndajnë veten të privuar për shkak të humbjes natyrore të një shqisë.

Kristaq F. Shabani

President i Lidhjes së Krijuesve "PEGASI" ALBANIA

Gjirokastër, dhjetor 2009

Ua kushtoj këtë libër fëmijëve të mi, drita e syrit dhe e jetës sime: Erionit dhe Dorinës, bashkëshortit tim, Eqremit dhe gjithë njerëzve që i dua dhe më duan.

Autorja

Të dalësh nga vetvetja

Vetë nuk dua emër
dua realitet,
në shpirt dhe në zemër
gjithçka e vërtet'.

Dhe nga zemra ime,
këto vargje buronjë
Gjithçka të vërtetë (vërtetësie)
të jetës tregojnë.

Se është vetë jeta ime,...
Copa jete gjen kushdo,
prandaj vëruni veshin
t'i gjeni vetë ato.

Malli për vendlindjen

I ëmbël është vendi,
E ëmbël është balta,
E bukur është tradita,
E thjeshtë është fjala.

Të gjithë të emigruarit
Po rikthehen prapë,
Disa për fitime,
Disa kanë shumë mall.

Diçka që e vë re
dhe është e vërtetë,
Të gjithë që vinë
po na shesin "lehtë" ...

Por të gjithë ta dinë,
Ta kenë të qartë:
Janë rritur me gur,
Rritur nga kjo baltë...

Shtegtimi

Ika, nënë, ika,
Nëpër lot shkova
Për ty, për familje
Unë nuk mendova.
Ika, nënë ika,
Nga sytë u verbova
Kisha një ëndërr:
Botën ta shtegtoja.

Erdha rreth e rrotull,
Kudo nëpër botë,
Nënë, vëlla, motër
Jo, nuk gjeta dot!

Erdha, nënë, erdha,
Erdha përsëri,
Jeta është e bukur,
vetëm në Shqipëri.

Jeta dhe vdekja

Po luftoj vdekjen,
Jetën po kërkoj,
Kudo, anë e mbanë,
Dhe s'po e gjej dot.

*Kudo që të vesh,
Është vështirësi
Të jetosh njësoj,
Si unë dhe ti.*

*Kudo qenka skëterrë,
Kudo që të vesh,
E lashtë fjala- proverb:
Gjithkush në vend të vet.*

*Por, ja një ditë,
Lindi shprese e re,
Të pashë në derë,
Që ti më erdhe.*

Kosova

Dola në dritare,
Më erdhi një zog
"Ciu, ciu, ciu",
Po qante me lot.
Tha: "Mbeta jetim,
Mbeta pa njeri,
S' kam vëlla e motër
Grua dhe fëmi...
Me shtëpi shkatërruar
të shtrirë përdhe
Më shporrën nga vendi
O Zot i madh ku je?!

*Në dheun tim,
më quajnë të huaj,
Dhe ja tani
Kaq dhimbje po vuaj.*

*

*Doja të jetoja
bashkë me zogun e mjerë,
Se ishim një komb
Në një truall të lerë.*

Kontrasti

Fshatit tim

Fshati im i dashur
*Me pakëz shtëpi,
Ikën të braktisën
banorët e rinj.*

*Dikur ishe i bukur
Kishe aq gjallëri
Tani mbete i mjerë
Edhe pa njeri.*

*Asgjë nuk shikon,
As zogj, as shpend,
Shtëpi të shkatërruara,
Jetë pa ekzistencë...*

S'jemi viktima

Shpesh e pyes veten
S'jemi njësoj unë dhe ti
Ti me përbuzje
Unë me mirësi.
Ndoshta ti po mburresh,
Se ke pasuri
Dhe unë jam i verbër
Dhe në varfëri.
Por diçka di
Dhe e besoj
Se vetë pasuria
Sytë t'i verbon.
Prandaj bëj apel
Se ke mundësi
Bamirëso për ne
Të kesh mbarësi.

Ndoshta të pafat,
Ndoshta, pa kuptim,
Ndoshta të stresuar,
Me shumë mërzë.

Duhet shumë forcë,
Duhet pak guxim,
Ndoshta, pak kurajë,
Të jetosh si të gjithë.

*E pse mos të bashkohemi,
Kështu ne të gjithë,
Përbuzjes së egër,
Bashkë t' i bëjmë sfidë.*

*Jeta është e gjatë,
Ndoshta dhe e vështirë,
Por, kur jemi bashkë,
Mposhtim padrejtësitë.*

Jeta apo realitet

***N**jë diell që lind,
Dhe do të perëndojë,
Një njeri që vjen,
Prapë do të shkojë.*

*Lulet në livadhe,
Zunë po lulëzojnë,
Jetën tonë të shenjtë,
Duhet të ndryshojnë.*

*Pak më optimistë,
Duhet të jemi,
Besimin te Zoti
Më tepër ta kemi.*

*Zoti që na dha jetën,
Prapë do të na marrë,
I lutemi Zotit,
Të jetë me radhë...*

Bota rrëmuje

Doni që të pyesni,
Ç'ndodh në këtë botë?
Jetë e vështirë,
Njerëzit shkojnë kot.
Këtu një vrasje,
Atje një hasmëri,
Më tutje një shitje,
Lart një tjetër tragjedi.

Djemtë nëpër burgjet
E botës përfundojnë,
Familjet e tyre
Me vite i kërkojnë.

Me qindra të zhdukur,
Në ferra e gërmadha,
Vrasin njëri - tjetrin
Vret kuçedër paraja...

Nënë

Dy pika lot
mbi faqe ranë,
Si dy pika shi
Ato ngjajnë...
Fjala e ëmbël "Nënë"

*m'u tha në buzë
me këta dy sy
nuk do ta shoh
më kurrë...
Syri qan
Shpirti loton,
Çdo ditë,
Çdo orë
Që në jetë kalon...
Por fjalën "Nënë",
Kurrë s'e harron.
Çdo çast nënën
Në jetë kujton.*

Zhgënjim

K*urrë mos u mashtro,
Kurrë mos gënje,
Tregohu i çiltër,
Ashtu siç je.
Gënjeshtra
dhe mashtrimi
Është i shëmtuar,
Prandaj edhe unë,
Nuk i kam provuar.*

*Prandaj mos harro,
Këtë mësim,
Se do të zhgënjehemi,
Si unë dhe ti...*

*E kisha menduar,
Por edhe e besoja,
Nga kjo miqësi,
Kurrë s'do të largohesha.*

Dhimbje

Kurrë në jetë s'e dija,
Kurrë s'e besoja,
Çfarë dhimbje në jetë,
Unë do të përjetoja.
Askush nuk e di
Unë e përjetoj.
Çaste të vështira,
Vetmimë s'e duroj .

*Shpirti është i vrarë,
Zemra e copëtuar,
Miq të edhe shokët,
Më kanë lehtësuar.*

*Por prapë Miqësia,
Kurrë nuk mjafton,
Mendoj për shumë gjera,
Diçka po kërkoj.*

E gjatë sa një fletë

Oh, jetë, o jetë,
E gjatë sa një fletë,
Që lindi në prill,
Dhe vjeshta e shtiu.

Vallë si punoi,
Edhe çfarë gëzoi,
Si shushunjë e keqe
Popullin e rropoi.

* * *

Ja erdhi një ditë,
Nga jeta u nda,
"Ishte qen bir qeni..." -
Gjithë populli tha.

Ndoshta ndjenjë

Thellë e më thellë,
Thellë në shpirtin tim,
Po ndiej një zë,
Që po kërkon ndihmë.

Jo s'është një britmë,
Është një ndjeshmëri,
Ndoshta është një emër,
Që as vetë s'e di.



*Ndoshta është një shoqe,
Ndoshta një miqësi,
Ndoshta është një motër,
Me zemër dhe shpirt.*

U KTHYE BUZËQESHJA

Jeta ime

***S**e çfarë kam në zemër,
S'mundem ta tregoj,
Vetëm Perëndia,
Mundet ta largojë.*

*Ta dhashë Besën,
Në sy të pashë,
Ti s'më besojë
Rrije shumë larg.*

*Ndoshta pabesia,
Shumë të mundoi,
Apo zemra jote
Tjetër dashuroi.*

*Edhe kur mendoj,
Me vete flas,
Sesi duroj
Dhe si nuk pëlças.*

*Por pas shumë kohësh,
Vite me stresime,
U kthye buzëqeshja,
Lumturia ime.*

Ndoshta

Ndoshta s' e besoja,
Thoja: "Jam në ëndërr,..."
Kur ti më flisje,
Bashkë me nënën.

*Një ditë e kuptova,
Se ishe ti ai,
Që pranove në jetë,
Të jetonim të dy.*

*Ndoshta e pranove,
Që kishe gabim,
Jeta do të ndryshojë,
është si në fillim.*

Nëse

Nëse një ditë,
Do të preferoja të heshtja,
Ishit ju
që s' do të më linit të qetë,...
Nëse një ditë,

*Do të vendosja të vdisja,
Ishte dashuria që kisha
Për ju
Ajo që s' do të më lejonte...
Nëse, vendosja të shkoja,
Diku larg,
Ishte merakun për ju
Dhe jetët tuaja,
Prandaj s' do ta bëja...
Këtë do ta kuptoni
Në një kohë tjetër
Afër ose larg qoftë.*

Shqipëria e bukur

Dola lart në male,
Oh, sa bukuri!
Pishat radhë - radhë,
Me plot gjelbërim.

*Me ujë të ftohtë,
Zogjtë cicërojnë,
Bagëtitë kullosin,
Fluturat fluturojnë...*

*Si këto malet tona,
Në botë nuk ka,
Pika turistike...,
Por turista s' ka!*

Kënga e Vajit

O shoqe, medet, medet,
Kam një hall e kam një brengë,
Të rinjtë shkuan në kurbet,
Këtu mbetën fëmijë e pleqtë.

S'kam ç'e dua emigrimin,
S'kam ç'e dua pasurinë,
Ka mall prindi për fëmijë,
Dhe fëmija s'mund të vijë.

S'kam ç'i dua paratë,
S'kam ç'e dua vilën katëshumë
S'e dua gruan pa burrë,
Dhe fëmijët me qarje lumë.

Syri i verbuar

Syri që u verbua,
S'kthehet përsëri,
Jetoje jetën,
Ashtu, si mendon ti.

Harroje dhimbjen,
Harroje trishtimin,
Ec në jetë përpara,
Se je më i miri.

*Shokët edhe miqtë,
I ke gjithmonë pranë,
Edhe po u zhgënjeve,
Harroi, leji mënjanë.*

*Kështu si ti,
Ka dhe shumë të tjerë,
Duhet të mendosh,
Se jeta ka shumë vlerë.*

Dhimbja

***N**doshta pse kjo pyetje,
Gjithë jetën do të më mundojë,
Ndoshta pse kjo pyetje,
Gjithë jetën do të më torturojë.*

*E lodhur nga një dhimbje,
Dhe mall i madh
E mbyllur në vetvete,
Se s'mund të them gjithçka.*

*Ndoshta dhimbja dhe malli,
S'do të jetë në perjetësi,
Dhe për mua do të ketë
Sadopak lumturi.*

Tomorri

O Tomorr, o vend i shenjtë,
Lutjen time e prano,
Nga mendimet e këqija,
Shpirtin tim ti e pastro..

Larg hakmarja dhe urrejtja,
Larg mallit dhe mërgimit,
Të ndërtojmë vendin tonë,
Të rritim punësimin.

Të mendojnë vetë për veten,
Të mos presim nga të tjerë,
Se pa punë jemi viktima,
Puna të bën njeri me vlerë.

S'ka para

Ndoshta po u kthye
Bota përsëmbari,
Do të fillojë një jetë e re,
Ndoshta do të arrihet
Një marrëveshje
Që e kaluara të jetë
Gjithmonë një heshtje.
A mos, vallë, është një luftë
Vëllavrasëse

*E do të sjellë fatkeqësi,
Apo mos ndoshta Zoti na dënoi
Se bota është në përfundim.
Jo, s'e besoj, se kjo botë do të mbarojë,
S'e besoj, se kjo jetë qenka në përfundim,
Por duhet të punojmë shumë,
Duhet të rritim ndryshe brezin e ri.*

Ndoshta ti

D*uhet të mendojmë
Jetën ndryshe,
Ta shohim njëri - tjetrin në sy,
Se një jetë do të jetojë...
Njëlloj si ti është ai.*

*Jeta është shumë e shenjtë,
Mendoje tjetrin si veten,
Se për të gjithë është njëlloj,...
Mundohu të jesh i drejtë,
Që dashuria të ekzistojë,...
Ktheje kokën dhe shiko
Se ku ishe dhe ku je,
Jeta është shumë e gjatë
Ndoshta edhe të gënjen.*

*Ktheje kokën dhe shiko,
Jetën tënde që në fillim,
Do të duket si një lojë
Që s'ka fund dhe mbarim.*

*Mos e gjyko të kaluarën,
Ajo iku, s'kthehet më,
Mendo tani e tutje
Që jetë të lumtur të kesh.*

*Që të falësh është humane,
Të dish e të respektosh,
Se respekti është mirësi,
Të duash familjen
Është detyrë dhe përgjegjësi.*

Gëzimi im

***D**ua të flas,
Dua të qesh,
Dua një këngë
Të këndoj,
Dua si një flutur,
Një valle të vallëzoj.*

*Dua të flas për Mirësinë,
E gjithë bota të ketë Qetësi,
Të zhduket droga dhe Ligësia,
Të mbizotërojë Vëllazëria,
Dhe Miqësia.*

*Do të doja kjo ëndërr,
Të bëhet realitet,
Çdo njeri të ketë
Lumturi në jetë.*

Bekimi i nënës

Do të doja,
Sa shumë do të doja,
Që të ishim bashkë:
Dy yje dhe dy ëngjëj
Si lulet që rrinë bashkë...

Do të doja që kjo jetë
Mos të na ndante kurrë më,
Mos të kishim mall për njëri-tjetrin.
Mjaft ne ndenjëm larg dhe të brengosur...
Dhe në fund të detit Ëngjëjt të mbrojnë
Dhe në gji të Perëndisë
Djalli të vret.

Prandaj po të them,
Vetëm një fjalë:
Keni bekimin tim
Për tërë këtë jetë.

Jetë a lojë

Çdo jetë ka një histori,
Çdo ngjarje është një tragjedi,
Çdo njeri që luan,
Luan
Vetëm me veten e tij.

Çdo gojëdhënë,
Çdo thashethem,
Në njëqind e një
Një është e vërtetë.

Një e them unë,
Një tjetër e bën dy,
Kur të soset fjala,
Askush nuk e di.
Ndryshe e thashë,
Ndryshe e kthejnë,
Askush s'e mori
Të vërtetën vesh

Ëndërroj

Pse të pyes njeri,
Pse as vetë s'e di:
Pranë gjithmonë më rri,
Një gjarpër i madh...
Një gjarpër i zi ...
Përse, asnjë shpjegim,
Nuk di, ku ta gjej,...
Mendohem dhe prapë
S'mund ta kuptoj.

Sesi këtë gjarpërim të zi
Si mundet ta largoj
Nga ky tmerr që më kanë zënë
Si mundet të shpëtoj.
Dua një mendim,

*Dua një këshillë,
Nuk di si të veproj.
Gjarpërinjtë e zinj
Më shtohen çdo ditë.*

Hija

*S'di nga vjen,
S'di nga urë,
Çdo natë në ëndërr
Më bën torturë.*

*Askujt s'i bëj keq,
Askujt s'ia bëj borxh,
Po vallë ky gjarpër,
Pse më torturon?*

*Kam frikë të fle
Kam frikë të hyj në dhomë,
Kam frikë se çdo çast,
Në dorë do të më kafshojë.*

*Çudi, sa çudi më vjen
Gjithmonë me të njëjtën dorë,
Këkron të më hedh helm!...
Dhe rri prapë mendohem
Dhe fitoj qetësinë,...*

Kthehem

Një ëngjëll të pret,
Të ka pritur shumë,
S'e di a e kupton,
Nga pas të ndjek.

*Ndoshta dhe e lodhur,
Nga kjo pritje e gjatë,
Shumë ka shpresuar,
Që të ishit bashkë.*

*Ndoshta dhe një ditë,
Shpresa do të mbarojë,
Dhe zemra e saj,
Duhet të gëzojë.
Ndoshta jo me sy,
Është larg, nuk të sheh,
Me shpirt dhe me zemër
Ti nga pas e ke.*

Ankthi

Nuk e di pse jam mërzitur,
Nuk e di se çfarë po kërkoj,
Nuk e di se ku jam nisur,
Nuk e di çfarë të mendoj...

*Nuk e di se çfarë të them,
Nuk e di si të tregoj,
As të qaj, as të qesh
Nuk e di si ta shpjegoj.*

*Jam një grua, jam një nënë,
Gjithçka dua të besoj,
Lutjen time në këto çaste,
Zoti vetë po e dëgjon.*

*A mos vallë në këtë botë,
Jeta është si një lule,
Që e mbjell në saksi,
E rrit i bën hysmet
Dhe thahet përsëri.*

Vetvetja

N*ë cep të qytetit,
Jetoje vërtet ti,
E ngrysur e zymtë,
E mbyllur në vetmi.*

*Mendon, ç'nuk mendon,
Për fshat e qytete,
Asnjëherë s'mendove,
Vetëm për vete.*

*Shumë njerëz të fyejnë,
Të lëndojnë në shpirt,
Por ti nuk vret mendje,
A s'do t'ia dish.*

*Shumë njerëz të shajné,
Pa ditur asgjë,
Ai që të sheh dhe të gjykon,
Është vetëm Një.*

SHKËPUT NJË LOT

Ti dhe fotografia

*E*rdhi si një ëngjëll,
Brenda në shtëpi,
Ndoshta për herë të parë,
Të pashë në fotografi.

*Nuk e di se ç'ndjeva,
Ndoshta në plotim,
Por kjo lumturi,
Nuk zgjati shumë ditë.
Ndoshta ajo ditë,
Do të vijë sërish,
Që të shoh shtëpinë,
Me shumë fëmijë.
Dy djem dhe dy vajza,
Të kem në shtëpi,
Por nuk e besoj
T'i shoh dot me sy!*

Dëgjoje zemrën çfarë thotë

Viktimës

Unise në shkollë,
S' erdhe në shtëpi,
Si do t'ia bëj unë,
Ku të gjej tani.

Vallë, si të gënjyen,
Ku shkove s'e di,
Jetën e shkatërrove
Që në fëmijëri.

Vallë, ku të çuan,
A je gjallë s'e di,
Vogëlushja ime,
Do të kaloj jetën në zi.

Ëndërr dashuria jote,
Të prita deri në mëngjes,
Nuk e di pse s'erdhe,
Të puth dhe pastaj të vdes.
Të prita të prita,
Prita deri vonë,
Nuk e di pse s'erdhe,
çfarë po të mundon.
Tani e kuptova,
Përse nuk po vjen,
Dikush të ka folur,

Dikush të gënjen.
Mos i beso fjalët ,
Që të thotë bota,
Ato janë të gjitha
Mashtrime të kota.
E kaluara s'kthehet më.

Mos e vra dhe një shpirt tjetër,
Se shpirti yt është vrarë,
Mos plagos zemrën tjetër,
Se zemra jote është plagë.

Mendo shumë gjera, mendo,
Sepse jeta jetohej një herë,
Ajo është në dorën tënde
Të jetosh i lumtur, apo pa vlerë!

Largo dhimbjen dhe trishtimin,
Gjeje rrugën tënde vetë,
Mendo atë që është më mirë,
Për ty dhe për djemtë.

Dëgjoje zemrën çfarë thotë,
Çfarë të thonë miq e shokë.
Mbi të gjitha, kush të tha:
"Lutju Zotit të të ndihmojë".

Ne dhe Zoti

O Zot, përse,
përse më dënove kaq rëndë,
Mos vallë kam bërë
Ndonjë gabim?
O Zot, përse s' e di,
Përse më ndëshkove
Me aq (vajë) lirinë time,
Me aq dritën e syrit?!

Edhe pse të jam lutur,
Edhe pse të lutem përditë,
Ti prapë, s' më dëgjon.
Mos vallë duhet të sillem ndryshe?

S' e di, por duhet që në jetë,
Të sillesh si tjetër njeri,
Të dalësh nga vetvetja,
Por këtë s' do ta bëj kurrë,
Sepse kjo është natyra ime:
Besoj tek ty dhe te vetvetja.
Edhe pse jam kështu,
Prapë do ta pranoj realitetin,
Sepse të pranosh realitetin,
Është diçka e bukur.

O Zot, më beso që jemi,
Unë dhe Ti deri në vdekje,
Dhe jemi të bindur
Që të kemi gjithmonë pranë.

*Njëlloj si unë
Plot të tjerë
Që e quajnë veten,
Njerëz pa vlerë.*

Oh, o Zot!

Nuk dua të shkoj,
Në asnjë vend,
Përveç shtëpisë.

*Nuk dal asgjekund,
Me askënd dua të rri,
E mbyllyr vetëm në dhomën time.*

*Nuk dua të flas
As me njeri,
Dua të flas vetëm,
Me veten time.*

*Besoj se askush s'mundet,
Të tregoj të vërtetën,
Përveç zemrës tënde.
Një yll shoh atje lart,
Të gjithë njerëzit me radhë,
Të mirë e të këqinj.
Ndoshta, ky yll që shoh,
Shëndrit më tepër se të tjerët,
Sepse do të shoh gjithë marrëzitë
Që bëjnë në këtë botë njerëzit.*

Shikon qytetin pa ujë e pa drita,
Sheh djemt që shkojnë larg,
Shikon nënat që qajnë fëmijët pa baba.
Nuk e di sesi duron,
Si nuk vepron, nuk e di
Njerëzit tek ti besojnë,
Zot i madh, i plotëfuqishmi i Botës.
Pse vrasin dhe vriten njerëz
Vdesim mijëra të rinj...
A mos vallë s' të kam besuar,
Dhe i shoh me pak dyshim?

Jeta është një për të gjithë,
Për të rinj edhe për çdo brez,
Lutem, që ti t' i lejosh
Dhe të rinjtë të bëhen pleq.

Ndoshta është marrëzi,
Ndoshta është çmenduri,
Por këtë lutje po e bëj,
Me gjithë zemër dhe me shpirt.

Lutjen time duhet ta bëjnë,
Të gjithë njerëzit në botë,
Sepse para jetës së tyre,
Paraja është e kotë.

Nu ka liri për askënd,
Nuk ka liri asgjekund,
Kudo që të pyesësh,
Kudo që të vesh.

Të gjithë e duan,
Të gjithë e kërkojnë,
Të gjithë e vuajnë,
Të gjithë e kanë brengë.

Vallë, kur do të vijë,
Vallë, do të kthehet,
Jetojmë me shpresë,
Por edhe shpresa ka një fund.

Nëse, do të kthehet një ditë,
Do të jem njeri më i lumtur në botë,
Por të kishte liri për të gjithë.

Vetmi

Izbres shkallët
Një nga një...
Dëgjoj zhurmën
E hapave të mia.

Mendoj
E çfarë nuk mendoj
Por diçka
Më bie ndërmend,
Që mendoj vetëm
për jetën time.
Oh, nuk është e vërtetë,
Se jeta qenka kaq e lehtë!

*I zbres shkallët
Një nga një,
Dëgjoj vetëm
Zhurmën e hapave të mia.*

*Kthehem nga puna,
Dëgjoj fjalët e shokëve
Që më flasin,... Gëzohem,
Por, vetëm për një çast,
Sepse heshtja
do të kthehet përsëri.*

*Zbres nga autobuzi
Dhe kthehem në shtëpi,
I hedh hapat ngadalë,
Por prapë trishtim
Dhe mërzë.*

*I ngjit shkallët tok, tok
Dhe dëgjoj zhurmën
E hapave të mi.
Dhe mendoj: "Oh, kjo jetë,
E kaluar në vetmi!"*

Hesht

Hesht,

Hesht

Dhe atëherë

Kur s' duhet...

Hesht

Dhe para fakteve

Të kryera

Para syve të mi,

Unë prapë

Hesht.

Heshtja

Të zë frymën...

Ndoshta

Është gjykatësi

Më i mirë

I ndërgjegjes

Sa s' mund

Të durosh dot më.

Duhet të flas,

Duhet të flas

Me forcë

Dhe me zë të lartë

Që një e drejtë

Të vihet

Në vend

Dhe të jem e qetë.

Shiu

Jashtë bie shi.
Si shi bien
Dhe lotët e mi, ...
Përse? ... Askush, s'e di.

Si shi pikon gjak,
Edhe zemra ime,
Nga plagët e jetës.

Shpirti është i vrarë,
Si shpirti i një
Të arratisuri
Në thatësirën
E një shkretëtire.

Shpirti i një bote tjetër,
Pa vlerë, pa dashuri,
Në një botë të varfër,
Jo nga pasuria dhe paraja.

Shkurtima

*

*Jeta është e gjatë,
Por aq e vështirë,
Mundohesh të gjesh
Atë që ke dëshirë.*

*

*Jeta është e bukur
Si lulja me erë,
Vetmia të lë të trishtuar
Të lë mjerë.*

*

*Jeta është skëterrë,
Kur dot s'e jeton,
Mashtrimi dhe intriga,
Shpirtin ta mundon.*

*

*Ndihesh e dhunuar,
Kur jetën kalon
Edhe një fjalë të mire,
Kurrë s'e dëgjon.*

*

*Shpesh ndodh në jetë,
Të ndahesh shumë keq
Këmbëngul dhe kërko
Atë që do të kesh...*

*

*Kur dhimbja dhe trishtimi
Në jetë të mundon
Ndoshta dhe gëzimin
dot s' e shijon...*

*

*Prindi dhe fëmija
Njëri tjetrin s' kuptojnë
Edhe dashuria e ndërsjelltë
Në jetë ndryshon.*

*

*Mali dhe bregu
Zunë po jeshilojnë
Por kjo jeta jonë,
Kurrë s' do të ndryshojë.*

*

*Deti dhe Qielli,
Jetë njerëzish marrin
Dritën dhe Diellin
Tokës i falin.*

*

*Shumë vite kanë kaluar
Të tjerë do të kalojnë,
Vetminë e kësaj dite,
kurrë s' e zëvendësojnë.*

*

*Puna është punë
Më lodh mua, të lodh ty ,
Më shumë lodh vetmia
Dhe në vend kur rri.*

*

*Shpirti është i lodhur
Zemra e copëtuar
Askush nuk e di
Si duhen qetuar....*

*

*O Zot i madh,
Më jep pak fuqi,
Të dal nga kjo gjendje,
mos kem më mërzë.*

*

*Veshi i shurdhuar,
Syri i verbuar,
Zemra e copëtuar,
Jetë e pagëzuar.*

*

*Burimi u tha,
Guri u çua,
Zemrën e copëtuar,
Asnjë nuk e pa...*

*

*Lumi u mbarua,
Pema u rrëzua,
Jeta e kaluar ,
Kurrë s'u harrua!*

*

*Lulja u tha
Dhe çeli përsëri,
Ai që iku
S'kthehet kurrë tek ti.*

*

*Jeta është
një det pa fund
dhe botë pa anë,
Vijnë dhe ikin
Njerëzit tanë...*

*

*Jeta është me dhe pa fat,
S'e kupton askush,
Me fat janë ata që kanë
Para dhe karrierë,
Por më me fat ata që bëjnë
Jetë modeste dhe me vlerë.*

*

*Ha, sikur
Do të vdesësh nesër,
Puno sikur
S'ke vdekje kurrë.*

*

*Shoqëria, miqësia,
Modestia, krenaria
Të mban gjallë,
Mbjell në shoqëri
Të bukurën farë.*

*

*Është thënë
S stërthënë
Zgjidhe shokun
Më të mirë
Se vetja
Se prej tij
Ke çfarë mëson.
Po a e kanë në jetë njerëzit
këtë "medalion"?*

*

*Mos qesh me mua
Se të tjerët
Do të qeshin me ty,
Kjo është radhë
Pa pyetshmëri.*

NJË BOTË E DHIMBSHME, E BUKUR DHE PLOT
NDJENJA

Jam i ngujuar

Dhe në vdeksha, mos më qani,
Se jam larg nga vatani...
Edhe dheu s' do më tresë,
Sepse vdes me mall dhe brengë.

Nëna dhe babai s' dinë,
Gjezdisa gjithë Azinë,
Amerikë dhe Kanadanë,
Gjezdisa gjithë dynjanë,

Jetoj gjithmonë me shpresë ,
Dhe s' dua që të vdes,
Të shoh dhe një herë vatanë,
Të shoh nënën dhe babanë.

Jam në burg i ngujuar
Shumë vite i dënuar,
Lirinë të pagëzuar,
Por një ditë me shpresim,
Jetën time në rizgjim.

Si unë ka dhe plot të tjerë,
Që familjet nuk i dinë,
Me vite të tëra i qajnë,
Ndoshta ju kërkojnë varrë.

Lënë grua, lënë fëmijë,
Por vallë si rrinë
Me vite të tëra të larguar
Dhe i gjejnë duke punuar...

Rriten djemtë, bëhen burra,
Venë i takojnë te puna,
Nuk njih djali babanë,
E përqaфон duke qarë.

Ah, ky shkurt dhe ata që do të vijnë

Shkurtin e mallkuar,
S'kam për ta harruar,
Gjithmonë në jetën time
Shumë më ka lënduar.
Ditën e dy shkurtit
S'kam për ta harruar,
Gjithë jetën time
Më ka shkatërruar.
Sa shkurte kaluan,
Të tjerë do të vijnë,
Por kurrë për mua,
S'do të sjellin lumturinë.
Si gjithmonë dhe sonte,
S'pres diçka të re,
Mërzia dhe trishtimi
Jetojnë me ne.

* * *

*S' dua të më gënjesh,
S' dua të më mashtrosh,
Por për jetën time,
Sadopak të mendosh.
Se është thjesht një lojë,
Është një tragjedi,
Të jetosh gjithmonë
ashtu si mendon ti.*

* *

*Me gojën e njerks flas
me zemrën e nënës dashuroj
me syrin kritik të shikoj,
por je një ëngjëll
që asgjë s'kupton.*

Shikoje syrin

Shikoje syrin tim çfarë thotë,
Dëgjoje fjalën time se çfarë të them,
Që kurrë të mos gabosh në jetë.
Është e lehtë të gabosh,
Të bësh, sikur s'kupton,
Por është e pamundur
Që gabimin të përmirësosh.
Është e lehtë falje të kërkosh,
Është pa vlerë të bësh fjalë,
Kur ti përsërit gabimin
Dhe del nga shtëpia
Dhe shkon diku larg.

Një kthim i paparë me sy

Një tufë lule që s't'i solla dot,
një fjalë të ngrohtë s'e ndiej,
ndoshta kjo është pasqyra ime.

Dua të kthej kohën pas ,
por s'mundem;
do të kisha dëshirë të të shoh.
Jeta ime jetime dhe e trishtë,
askujt në jetë s'do t'ia uroja.
E vogël isha ende fëmijë
S'e kuptoja se ç'po ndoshte,
e dija se një ditë do të ktheheshe,
prapë me sy do të të shihnim.

Ç'bukuri kanë këto troje!

Dola në Çajup në majë
të shikoj gjithë dynjanë,
Fshatra të tëra përreth,
Gjirokastra në mes.
Gjirokastër, moj me vullë,
shtëpitë mbuluar me gurë,
Rrugët shtruar me kalldrëm,
Argjiron nuse në këmbë.
Si nuri i bukur shumë,
lumi Drino shtrirë,
kur e sheh, si ngjalë,

*të lë pa fjalë...
Por edhe Korça ime e shtrenjtë,
që s'ë harroj përjetë....
Kështu është Shqipëria,
Kosova , Çamëria.*

**Jam një botë e dhimbshme, e bukur dhe plot
ndjenja.**

***M**blodha gjithë vitet e jetës
për të bërë një ditar,
mbloodha gjithë lulet e verës
për të bërë një buqetë.
Mbloodha gjithë emrat e shoqërisë sime
që të mos t'i harroj përjetë.
Mbloodha gjithë fjalët e mia,
që ekzistojnë në botë
dhe fillova t'i mësoj,
sepse ato janë të shtrenjta
dhe në jetë të ndihmojnë.
Të ndihmosh sa më shumë njerëz
që ke mundësi,
nëse je njeri besnik
të mos kesh urrejtje, veç mirësi
dhe të falësh dashuri.
Nëse do të kisha forcën tënde
do të jepja një këshillë,
nëse njerëzit do të më dëgjonin
s' do të pranonin kurrë tradhtinë.
Me sa duket në këtë botë*

gjithçka është e kotë....

***Thonë se gjoja besojnë
dhe thonë na fal, o Zot!***

*Se është një lutje pa pretendime,
para teje, o Zot iu madh,
dëshirën time për të ndihmuar,
askush s'mund ta ndalë.*

*Dhe ja tek vjen premtimi im,
si një dallëndyshe në fluturim*

*Premtoj të bëjë mirë në këtë botë,
Dhe siç shikohet nëkaq reshta,
jam një botë e dhimbshme,
e bukur dhe plot ndjenja.
prandaj në këto ndjenja,*

“Nënë, më beso që kam shumë mall, ...”

M*ë ka marrë malli,
shumë më ka marrë ,
në dorën time mbaj një celular,
Mezi pres çdo ditë
zërin të dëgjoj,
me zemrën plagë
dhe sytë që lotojnë.
Më ka marrë malli,
për ty, o shpirt,
se jeta ime po shter çdo ditë.
E shtrirë në shtrat,
veç për ty mendoj
se s'di ç'flas
dhe zërin s'ta dëgjoj.*

2.

Ishte mesnatë
dhe zilja ra:

*"Nënë, jam unë ...", -
një zë më tha.*

*U befasova nga ai zë,
sa s'besova për një çast,
por mblodha veten
dhe i thashë: "Tani që fole
s'do të më largohesh më".*

*"Nënë, më beso
që kam shumë mall,
por edhe unë do të vij prapë
aty tek ti,
më beso, të lutem, më beso
që kam një hall
dhe s'mundem të të shoh.
Pësova një aksident
dhe u verbova nga sytë.*

Jam në ankth dhe në mërzi

Do të doja një pikturë,
do të doja një portret,
nga vendi më i bukur
nga vendi më i shtrenjtë...
Ku jam rritur këmbëzbathur,
herë me bukë e herë pa bukë,
ku jam rritur me mundime,
ku kalova jetën time.
Imazhi më ndjek nga pas
dhe pse ika
dhe e lashë,...
Jam në ankth
dhe në mërzi,
sa ta shoh përsëri.
S'di a do të shoh më,
se jam larg e s'mund të shkoj,
por gjithë këtë mall
që kam në zemër
nuk di ku ta çliroj.

Mbirë kudo dashuri,

Rrugës tatëpjetë, kur vije
me kalldrëme shtruar-o,
Bastunin, një palë tespije
në dorë i mbaje -o...

*Trup të gjatë dhe gojëmjaltë,
Mbirë kudo dashuri,
Plakun me thinja të bardha
e respektojnë të gjithë.
Jemi shumë miq të mirë
është për mua si baba,
sepse më duket, kur më flet,
sepse jam unë më e vogla.*

*Kam dëshirë që ta pyes,
kam të dëshirë të bëj bisedë,
sepse është njeri me mend
me titullin më të lartë.*

Kjo bukuria jote

L*ëndinës që tutje vije,
moj e bardhë e bukur-o,
jelekun qëndisur me ar,
vogëlushe e vogël –o...*

*S'e besova, kur më erdhe
edhe mu afrove-o,
Zogjtë e malit seç u trembën
Nga bukuria jote
vashëz-o, o e miro.
Dielli të shndriti fytyrën,
sytë seç të çelin –o,
s'e di përse ke dalë
a do të më përgjigjesh-o.*

*Të lutem, më kthe një fjalë
Që nga vjen dhe ku po shkon,
Me heshtjen tënde më çmende,
moj e mira vashëz-o!*

Lypsari , dielli, qielli dhe njerëzit

Braktisur nga jeta,
braktisur nga familja
ngelur në katër rrugët e kalldrëmta,...
Endesh rrugëve të qytetit,
duke zgjatur dorën,
por, aty -këtu fiton ndonjë lekë ,
sa të blesh një copë bukë.
Krevati yt është pllaka e ftohtë
e kalldrëmeve,
Jorgan qielli i kaltër
dhe yjet që natën ndritin.
Për ata që i kanë parë
dhe i shohin përditë
Ju habitet mendja fare
qeshin dhe shkulin brinjët.

*Mos pandehni se kjo botë,
ka qenë si është sot
dhe ditët që do të vijnë
besoj se do të bëhet më mirë.*

Imazh nëne

Ndoshta një imazh,
ndoshta një mall i madh
në zemrën time,
apo një hije në atë vend.
Nuk dua ta harroj
atë fytyrë të rrudhosur
dhe flokë të bardha,
të ulur në stol:
rrinte dhe qante me mall
për vendlindjen e saj.
S'e harroj fytyrën e qeshur,
kur vija dhe thoshte:
"Ah, bir i nënës, erdhe!"
Por prapë me trishtim thoshte:
"Po kur do të shkosh? -
dhe në sytë e saj shihja lot. -
Nëna për ty, o shpirt nuk duron dot!"

Eh, sa na mungojnë

Brezi e ergjendtë,
pse jo brez i artë,
brezi juaj i drituar,
me penë dhe dramë.
Dikur nëpër skena,
sot me flokë të bardhë,
i jepni sot jetës

*vetëm një mesazh...
Keni për të thënë
shumë në këtë botë,
Arti dhe kultura juaj
Eh, sa na mungojnë.
Disa kanë ikur
dhe disa jetojnë,
Duhet që në skenë ,
duhet të mbijetojnë.*

Vajzat me lule "dielli"

N*ë mesin e fshatit,
një çezëm e bardhë,
Vinin edhe mbushnin ,
ujë me radhë.
Vashat bukuroshe
me sytë bojë qielli,
Bucelat mbi supë
në dorë lule "dielli".
Por vallë ç'i duan,
vashat këto buqeta,
Mos donin që t'ju falnin
nënave për festa?
Vinin në shtëpi
me plot gëzime,
Dhe i përqaфонin
Me një mijë urime.*

Një "minierë" e tërë

Një rrugë e gjatë,
një tunel i thellë,
Errësirë e plotë,
ndoshta një minierë.

*Një minierë e tërë,
plot me mineral,
Miliona të tëra,
apo një thesar.*

*S'mund ta marrin me mend,
a nuk e vlerësojnë
Një letër dhe laps
diçka për artin thonë.*

FABULA

Gjelat

Dy gjela që dolën
afër në lëndinë,
Po hahen të dy,
kush këndon më mirë.
Por aty pranë kalon
një gjel i tretë:
"Tani këndon ju
do t'ju gjykoj vetë".
Këndoi i pari
si të ishte trim,
Këndezi i dytë
si të ishte gërnëtë.
"U tha dëgjoni mirë
S'jeni në nivel.
Por dëgjoni mua
se si do t'ia them,
Kënga me tre zëra,
është kënga e vërtetë".

Loja e kokoshit

Kokoshi me pulat
dolën në kullotë.
Aty pranë tyre
kaloi dhelpra zonjë.
“Ah, kokosh i dashur,
bukur po këndon,”
dhe me shumë lajka,
kërkon ta gllabërojë.
Porsa u afrua
kjo dhelpra dinake
Gjeli e kuptoi
mbi pemë fluturoi.
Pastaj i tha dhelprës:
“Oh , moj dhelpra plakë,
po deshe të më hash,
Eja këtu lart”.
Dhe dhelpra dinake,
mbeti me gisht në gojë.

Fat dhe realitet

Një Bos dhe një Fukara
bisedojnë me shaka,
Bosi thotë: “ Jam me fat,
se s’kam seç t’i bëj paratë.
Fukarai ia pret shkurt:

*"Jam në hall dhe jam në dert,
Fëmijëve s'iu jap dot bukë!"
Por një ditë Bosit papritur,
i bie të fikët në rrugë,...
I tha fukarai i shkretë
se paraja s'bënte punë.*

*"Puno dhe derdh djersë
të jesh kështu si unë,
Se puna është nder
të bën të fortë për besë".*

Janë të gjithë shokët e mi!...

Dy ujqër pa mendje fare,
po na bënë disa plane.
Njeri thoshte: "**Pa dyshim**
të pret gjyqi, more i zi,
sepse ti je hajdut
më vodhe gjithë pasuritë..."
Tjetri fliste, si i marrë:
"Bëje, bëje, po ta mban.
Gjykatë dhe prokurori
janë të gjithë shokët e mi!...
Miq e shokë kam plot,
prandaj mos u mundo kot,
sepse jam vetë i parë,
kot që flet, more i marrë!"

PERMBAJTJA

| | |
|------------------------------|----|
| Të dalësh nga vetvetja | 7 |
| Malli për vendlindjen | 8 |
| Shtegtimi | 9 |
| Jeta dhe vdekja | 9 |
| Kosova | 10 |
| Kontrasti | 11 |
| S'jemi viktimi | 12 |
| Jeta apo realitet | 13 |
| Bota rrëmujë | 14 |
| Nënë | 14 |
| Zhgënjim | 15 |
| Dhimbje | 16 |
| E gjatë sa një fletë | 17 |
| Ndoshta ndjenjë | 17 |
| U kthye buzëqeshja | 18 |
| Jeta ime | 18 |
| Ndoshta | 19 |
| Nëse | 19 |
| Shqipëria e bukur | 20 |
| Kënga e Vajit | 21 |
| Syri i verbuar | 21 |
| Dhimbja | 22 |
| Tomorri | 23 |
| S'ka para | 23 |
| Ndoshta ti | 24 |
| Gëzimi im | 25 |
| Bekimi i nënës | 26 |
| Jetë a lojë | 26 |
| Ëndërroj | 27 |
| Hija | 28 |

| | |
|----------------------------------------------------------|----|
| Kthehem | 29 |
| Ankthi | 29 |
| Vetvetja | 30 |
| Shkëput një lot | 31 |
| Ti dhe fotografia | 31 |
| Dëgjoje zemrën çfarë thotë | 32 |
| Ne dhe Zoti | 34 |
| Oh, o Zot! | 35 |
| Vetmi | 37 |
| Hesht | 39 |
| Shiu | 40 |
| Shkurtima | 41 |
| Një botë e dhimbshme, e bukur dhe plot ndjenja | 46 |
| Jam i ngujuar | 46 |
| Ah, ky shkurt dhe ata që do të vijnë | 47 |
| Shikoje syrin | 48 |
| Një kthim i paparë me sy | 49 |
| Ç'bukuri kanë këto troje! | 49 |
| Jam një botë e dhimbshme, e bukur dhe plot ndjenja. | 50 |
| "Nënë, më beso që kam shumë mall, ..." | 51 |
| Jam në ankth dhe në mërzi | 53 |
| Mbirë kudo dashuri, | 53 |
| Kjo bukuria jote | 54 |
| Lypsari , dielli, qielli dhe njerëzit | 55 |
| Imazh nëne | 56 |
| Eh, sa na mungojnë | 56 |
| Vajzat me lule "dielli" | 57 |
| Një "minierë" e tërë | 58 |
| FABULA | 59 |
| Gjelat | 59 |
| Loja e kokoshit | 60 |
| Fat dhe realitet | 60 |
| Janë të gjithë shokët e mi!... | 61 |



Hurma Çallëku lindi në Korçë. Shkollën mesme e përfundoi në Moglicë, Korçë. Qysh nga viti 2001 banon në qytetin e Gjirokastrës.

Pasioni për Letërsinë ka qënë i vijueshëm, pavarësisht se është me aftësi të kufizuar të të pamit dhe në vitin 2004 bëhet anëtare aktive e Shoqatës së të Verbërve, Dega Gjirokastrër dhe është veprimtare e saj.

Libri “Me sytë e Diellit kundroj” është një “metaforë” intriguese dhe domethënëse si dhe një akt në veprim; është një tufë mesazhi për Shoqërinë, individin dhe gjithë organizmat drejtuese e të zgjedhura për të kthyer sytë nga këta njerëz, të cilët e kanë shpirtin të mbushur me shpresë dhe dritë njerëzore.

*Dy pika lot
mbi faqe ranë,
Si dy pika shi
Ato ngjajnë...
Fjala e ëmbël
“Nënë”
m'u tha në buzë...
Me këta dy sy,
nuk do ta shoh
më kurrë...*



Çmimi 400 lekë 4 €